



01/Nr. 820 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12,40, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 05/L-125 për vitin 2017 neni 9 pika 1.2 dhe pika 5, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2017 merr:

VENDIM

PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE TË VITIT 2015 DHE 2016 NË VITIN VIJUES 2017

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2015 dhe 2016 në vitin vijues 2017.

II

Të hyrat e bartura nga viti 2015 në vitin 2016 kanë qenë në shumën prej 129,093.66 € dhe prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 106,108.28 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 22,985.38 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2016 kanë qenë në shumë prej 251,831.04 €, prej tyre janë të shpenzuara 188,624.28 €, kurse për bartje janë edhe 63,206.76 €.

III

Pra, të hyrat vetanake të vitit 2015 dhe 2016 në total janë në shumën prej 86,192.14 €, të cilat i bartim për vitin 2017.

IV

Këto mjete i shpërndajmë nëpër këto programe / nën-programe buxhetore dhe kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 3,379.92 €; shpenzime komunale në shumë prej 558.00 €; subvencione dhe transfere në shumë prej 6,300.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 75,954.22 €.

V

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 3,379.92 € në programet si vijon: Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16035) në shumë prej 1,305.68 €; Administrata dhe personeli (163) nën-programi (16335) në shumë prej 994.98 €; Shërbimet Publike (180) nën-programi (18444) në shumë prej 369.22 €; Bujqësi, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470) nën-programi (47116) në shumë prej 87.21 €; Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730) nën-programi (75050) në shumë prej 563.05 €; Arsimit dhe shkencë (920) nën-programi (92175) në shumë prej 59.78 €.

VI

Në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shuma prej 558.00 € në programet: Administrata dhe personeli (163) nën-programi (16335) në shumë prej 468.00 €; Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730) nën-programi (75050) në shumë prej 90.00 €;

VII

Në kategorinë ekonomike **subvencione dhe transfere** shuma prej **6,300.00 €** në programin: Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16035).

VIII

Në kategorinë ekonomike **shpenzime kapitale** shuma prej **75,954.22 €** në programet si vijon:

1. Në programin Administrata dhe Perosneli (163) nën-programi (16335) në projektin:

“Mbulimi i parkingut dhe rregullimi i garazhës për automjetet zyrtare” kodi (45624) në shumë prej 10,000.00 €;

2. Në Programin Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) në projektet:

“Ndërtimi dhe rregullimi i proces në Lagjen e re” kodi (41624) në shumë prej 27,954.22 €;

“Mjete të lira për bashkëinvestime” kodi (41641) në shumë prej 20,000.00 €;

“Fond për hartim të projekteve” kodi (41642) në shumë prej 8,000.00 €.

3. Në programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (75050) në projektin:

“Rregullimi i oborrit dhe bodrumit të QPS-së” kodi (45663) në shumë prej 10,000.00 €.

IX

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela për alokimin e buxhetit në nivel të nënkategorive dhe zërave buxhetorë.

X

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

XI

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 23.02.2017





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.887/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Ligji për Eficiencën e Energjisë Nr.04/L-016 neni 3 pika 1.8, 9 pika 2, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2017 merr:

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË
2017 – 2022

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin komunal për eficiencë të energjisë 2017-2022.

II

Planin komunal për eficiencë të energjisë 2017-2022 në Komunën e Hanit të Elezit i përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi është hartuar nga grupi punues i komunës së Hanit të Elezit dhe ekspertët nga shoqata e eficiencës së energjisë, i cili përmban gjithsej 29 (njëzet e nëntë) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 23.02.2017

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 817/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2017 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2016.

II

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

III

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 23.02.2017





01/Nr.798 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2017 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE TË MJETEVE BUXHETORE PËR VITIN -2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve të mjeteve buxhetore për vitin 2016.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin - 2016 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit është 2,066,396.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 2,309,938.90 € (duke përfshirë bartjen e të hyrave vetanake në shumë prej 129,093.66 €, mjetet shtesë me rishikim të buxhetit në shumë prej 40,000.00 € nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pastaj donacionet që kanë hyrë përmes llogarisë bankare nga Organizata Zvicerane Demos në shumë prej 44,167.58 € dhe në fund nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë lëshuar mjete shtesë për të mbuluar kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në shumë prej 30,281.66 €). Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe mëditje 1,396,797.66 €, mallra dhe shërbime 212,025.50 €, shpenzime komunale 48,813.66 €, subvencione dhe transfere 53,546.50 € dhe shpenzime kapitale 598,755.58 €. Pjesën më të madhe të këtij buxheti e kanë pagat dhe mëditjet me 60.47%, shpenzime kapitale me 25.92%, mallrat dhe shërbimet me 9.18 %, subvencionet dhe transferet me 2.32% dhe shpenzimet komunale me 2.11%. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i realizimit të përgjithshëm për këtë periudhë janar-dhjetor 2016 është në shumë prej 2,189,896.64 € apo 94.80 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,391,496.63 € (99.62%), në mallra dhe shërbime 211,387.17 € (99.70%), në shpenzime komunale 48,263.58 € (98.87%), në subvencione dhe transfere 53,158.50 € (99.28%) dhe në shpenzime kapitale 485,590.76 € (81.10%).

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 23.02.2017

Kryesuesi i Kuvendit

Qamush Brava

